



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:190166

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05420789

**AA.nr.565/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative,** në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses N.S, nga Fushë Kosova, e cila përfaqësohet nga avokat Zijadin Spahiu, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesave të paditëses, kundër aktgjykimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1957/2021 të datës 18.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohen** si e pabazuar ankesa e paditëses N.S, nga Fushë Kosova, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1957/2021 i datës 18.05.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1957/2021 të datës 18.05.2023, është refuzuar kërkesëpadia e paditëses N.S, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Pensioneve i datës 03.07.2021.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesa paditësjë, për shkak të: shkeljes së dispozitave të LPA-së dhe LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar dhe jo të drejtë të së drejtës materiale. Me propozim që aprovohen në tersi ankesa e paditëses e ushtruar kundër aktgjykimin të ankimuar, si e bazuar, të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë duke ia njohur paditëses të drejtën në pension me përgatitje superiore të pensionit të shkallës së III-të

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimet e ankimuara, pretendimet ankimore në ankesa, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

### **Ankesat janë të pa bazuara**

Nga shkresat e lëndës rezulton se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me vendimin e datës 09.07.2021, e ka refuzuar ankesën e parashtruar nga ankuesi z/znj N.S me numër të ID-së:..., për njohjen e të drejtës në Kategorizim me shkollim superior.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 26.08.2021, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses të paraqitur kundër vendimit të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Pensioneve të datës 03.07.2021, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të lartcekur të paditurës. Me arsyetim se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar. Departamenti i Pensioneve më dt. 03.07.2021 ka refuzuar ankesën e paditëses si të pa bazuar për njohjen e të drejtës në kategorizim me shkollim superior. Në arsyetimin e vendimit të kontestuar me padi dhe duke vepruar sipas rekomandimit të Aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr. 740/18 të dt, 01.06.2021 ka theksuar se edhe përkundër faktit që ankuesja tani paditësja ka kërkuar që ti njihet kategorizimi me shkollim superior, një kërkesë e tillë nuk është na harmoni me pikën 5 të nenit 5 të Udhëzimit administrativ Nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues ngase kualifikimi shkollorë nuk është në harmoni me kornizën ligjore. Për të vërtetuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar me padi, Gjykata e shkallës së parë i referohet nenit 5 para 4 të Udhëzimit administrativ Nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontribut pagues, i cili përcakton se “shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues për përgatitje shkollore superiore konsiderohet pensionisti i cili ka kryer Fakultetin apo studimet pasuniversitare”. Lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike, Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se pala paditëse i referohet dokumentit përkatësisht certifikatës së notave duke specifikuar provimet e dhëna në Fakultetin Juridik, por nuk posedon diplomë universitare në drejtësi konform kriterëve të përcaktuara me nenin 5 para 4 të Udhëzimit administrativ Nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues që të kualifikohet për të përfituar pensionin me shkollim universitar. Në shkresa të lëndës përkatësisht në ankesën e parashtruar nga paditësja kundër vendimit të organit të paditur, paditësja edhe vet ka pranuar se nuk ka dhënë provimin e drejta ndërkombëtare private. Gjykata e shkallës së parë po ashtu ka analizuar edhe provat të tjera të paditëses që kanë të bëjnë me përvojën e punës si

dhe kontributet por të njëjtat nuk mjaftojnë që gjykata e shkallës së parë të konstatoj se janë plotësuar kriteret e përcaktuara me nenin 5 para 4 të Udhëzimit administrativ Nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontribut pagues. Prandaj, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material. Gjukata e shkallës së parë ka vlerësuar pretendimet e paditëses, por ka gjetur se të njëjtat janë të pabazuara në ligj, për shkak se paditësi nuk ka ofruar dëshmi të bazuara me të cilat do të argumentonte pretendimet ankimore lidhje me shkeljet e pretenduara të organit të paditur.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimet e ankimuar nuk janë të përfshira me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjukata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se padia e paditësit dhe kërkesa për aktgjykim plotësues janë të pabazuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LPK-së dhe LKA-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata nuk ka vlerësuar drejt gjendjen faktike pasi paditësi gjatë tërë shekullit të punës ka punuar si jurist, me një provim mangut për arsye diskriminuese të kohës së monizmit, ndërsa kontributet janë paguar në tersi me përgatitje superiore me fakultet, prandaj gjykata është dashur të ketë parasysh gjendjen faktike dhe lëndën e kësaj gjykate me të njëjtën bazë juridike që është lënda A.Nr.740/18 ku provat materiale janë shtjelluar në tersi dhe është dashur të i bashkëngjitet kësaj lënde. Gjithashtu, kolegji i kësaj gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses, ka nxjerr prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses janë të pabazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga provat e administruara rezulton se në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, gjykata pasi ka shqyrtuar provat e administruara dhe dispozitat ligjore në fuqi mbi bazën e të cilit është bazuar vendimi kontestues me të drejtë konstaton se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka refuzuar ankesën e paditëses për arsye se, paditësja nuk i plotëson kriteret ligjore që ti njihet e drejta e pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore superior. Gjukata e shkallës së parë nga provat e administruara ka vërtetuar se e paditura e ka vërtetuar gjendjen faktike në harmoni të plotë me dispozitat ligjore në fuqi. Nga kjo gjendje faktike të

mbështetur në provat e siguruara gjatë procedurës administrative, gjykata e shkallës së parë me të drejtë pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se paditësja nuk ka prezantuar dëshmi me të cilat vërtetohet se ka përfunduar studimet me shkollim superior. Ashtu siç është paraparë në nenin 5 par. 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues. Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë me të drejtë pajtohet me qëndrimin juridik dhe faktike të paditurës pasi që në kontekst të argumenteve ligjore dhe provave të paraqitura në këtë konflikt administrative paditësja nuk ka mundur me argumentuar një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura, po ashtu në arsyetimin e vendimit kontestues është bërë vlerësim i fakteve në harmoni me dispozitat ligjore. Prandaj, nga këto arsye kolegji i kësaj gjykate vlerëson se vendimi i kontestuar është i drejtë dhe i bazuar, se ka mbështetje në provat e administruara, si dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme nga gjykata e shkallës së parë, të cilat arsye edhe kolegji i kësaj gjykate i pranon.

Ndërsa pretendimet ankimore të paditëses se aktgjykimi i ankimuar është marrë me shkelje të dispozitave të së drejtës materiale. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore i konsideron si të pa bazuar, ngase nga shkresat e lëndës vërtetohet se pretendimet ankimore për nivelin e përgatitjes shkollore nuk janë në harmoni me bazën ligjore të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut Pagues. Meqë, paditësja ka bashkangjitur si prova Certifikatën e notave duke specifikuar provimet e dhëna në Fakultetin Juridik por nuk posedon Diplomë Universitare në drejtësi konform kriterëve të përcaktuara me nenin 5 par.4 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 për Kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues që të kualifikohet për të përfituar pensionin me shkollim universitar.

Prandaj, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitat e Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut Pagues. Andaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë janë të qarta dhe të kuptueshme, ndërsa në arsyetimin e tyre janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Prandaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditëses.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

AA.nr.565/2022 me datë 14.02.2024

**Kryetari i kolegjit,**  
Ramiz Kuqi